

Udhëzues për kujdestare dhe kujdestarë

I. Këshilla dhe informacione të përgjithshme

Me marrjen e kujdestarisë së pjesshme¹ ju përmbushni një detyrim qytetar të rëndësishëm. Ju merrni përsipër një detyrë vullnetare, të cilën duhet ta kryeni me ndërgjegje dhe përgjegjësi dhe vetëm në interes të personit, që është nën kujdestarinë tuaj.

Dispozitat ligjore në lidhje me kujdestarinë e pjesshme janë të përcaktuara në Kodin Civil (nenet 1909 deri 1921).

Në përputhje me nenin 1915 të Kodit Civil gjejnë përdorim gjithashtu dispozitat ligjore mbi kujdestarinë ligjore (nenet 1773 deri 1895 të Kodit Civil). Është e këshillueshme të informoheni rreth këtyre dispozitave.

Gjykata për Çështjet Familjare mbikqyr veprimtarinë tuaj dhe ju këshillon lidhur me të gjitha pyetjet që kanë të bëjnë me detyrën tuaj.

Nëse ju kërkohet, jeni të detyruar të informoni Gjykatën për Çështjet Familjare mbi ushtrimin e detyrës suaj.

Ju jeni përgjegjës për dëmet, që mund t'i shkaktohen personit, i cili ndodhet nën kujdestarinë tuaj, si rrjedhojë e shkeljes së detyrimeve dhe përgjegjësive nga ana juaj, sidomos në rastin kur neglizhoni të kërkonti pagesën e alimenteve apo plotësimin e detyrimeve të tjera ndaj personit për të cilin kujdeseni. Ndaj këtij rreziku mund të siguroheni – informacione të mëtejshme mund të gjeni pranë Gjykatës për Çështjet Familjare.

Paratë e personit që është nën kujdestarinë tuaj duhet të depozitohen me interesa bankare, për aq kohë sa ato nuk përdoren për shpenzime aktuale. I përshtatshëm është kryesisht depozitimi në një llogari kursimi të ngrirë, tek e cila është vendosur shenja e bllokimit, pranë një banke shtetërore kursimesh absolutisht të sigurtë ose tek një bankë tjetër, e cila i përket një institucioni të sigurtë për depozitime parash, ose ato mund të investohen në një hipotekë të sigurtë apo dhe në letra me vlerë të sigurta. Gjykata për Çështjet Familjare mund t'ju lejojë një depozitim tjetër, p.sh. pranë një banke private të përshtatshme.

II. Vetëm për kujdestarinë e pjesshme që mbron interesat financiare të fëmijës ndaj prindit (pagimin e alimenteve)

Duhet të keni parasysh këshillat dhe informacionet e mëposhtme:

1. Detyra juaj është në rradhë të parë të kujdeseni që prindi, i cili ka detyrime financiare ndaj fëmijës (pagesa e alimenteve) t'i shlyejë ato. Për këtë fillimisht mund t'i bëni prindit kërkesë me shkrim. Dispozitat ligjore lidhur me detyrimet financiare të prindërve ndaj fëmijëve janë të përfshira në nenet 1601 deri 1615 të Kodit Civil. Shuma e këtyre detyrimeve financiare varet nga situata sociale dhe financiare e fëmijës në nevojë dhe përfshin në përgjithësi të gjitha nevojat e fëmijës për të jetuar, gjithashtu edhe shpenzimet për edukim dhe shkollim. Pra ligji nuk përcakton një shumë të caktuar. Prindi që ka detyrimin financiar është i detyruar të paguajë për fëmijën edhe atëherë, kur për këtë arsye ndikohet negativisht situata e tij financiare. Në këtë rast ai është i detyruar të përdorë të gjitha mjetet dhe mënyrat për të siguruar në të njëjtën masë jetesën e tij dhe të fëmijës së tij. Pra shuma që duhet t'i paguhet fëmijës nga prindi varet nga të ardhurat e këtij të fundit.

¹ „Vormundschaft“ dhe „Pflegschaft“ janë të dyja forma të kujdestarisë, e cila i kalon një personi të tretë kur prindërve u hiqet me vendim gjyqi përgjegjësia prindërore. Në rastin e parë prindërve u hiqet plotësisht dhe kundër dëshirës së tyre përgjegjësia prindërore. Në rastin e dytë prindërve u hiqet përgjegjësia prindërore pjesërisht ose me dëshirën e tyre. Për t'i dalluar këto dy forma nga njëra-tjetra në vazhdim do të përdoret termi „kujdestari ligjor“ për të parën dhe „kujdestari e pjesshme“ për të dytën. Personi që e ushtron këtë detyrë do të quhet në të dyja rastet „kujdestar/e“ [Shënim i përkthyeses].

2. Pagesat (alimentet) që hyjnë në llogari duhet të përdoren vetëm për personin që ndodhet nën kujdestarinë tuaj.
3. Nëse prindi, që është i detyruar të paguajë nuk ka dëshirë të përmbushë detyrimin e tij, ju – pasi t'i keni dërguar letër-kujtesën për kryerjen e pagesës – duhet të kërkonti në emër të personit për të cilin kujdeseni kryerjen e pagesës me vendim gjyqi. Për këtë qëllim duhet t'i drejtoheni Zyrës së Minorenëve apo Gjykatës së Shkallës së Parë, të cilat ju japin informacione të mëtejshme, por që nuk lejohet t'ju këshillojnë nga ana ligjore.

III. Vetëm për kujdestarinë e pjesshme për personat e humbur apo të zhdukur

Detyra juaj është të kujdeseni brenda kufijve të caktuar nga Departamenti për Çështjet e Kujdestarisë [Betreuungsgericht] lidhur me çështjet e pasurisë të personit në mungesë, dhe, për aq sa e lejon fusha juaj e veprimit, jeni i autorizuar të përfaqësoni personin në mungesë.

Nëse më vonë mësohet vendqëndrimi i personit në mungesë apo ky i fundit vdes, lidhur me këtë duhet të njoftohet Departamenti për Çështjet e Kujdestarisë.

IV. Përfundimi i kujdestarisë së pjesshme

Detyra juaj përfundon

- a) me heqjen e kujdestarisë nga ana e Departamentit për Çështjet Familjare [Familiengericht] apo me heqjen e kujdestarisë për personin në mungesë nga Departamenti për Çështjet e Kujdestarisë, si dhe
- b) në rastin e kujdestarisë së pjesshme për një person që ndodhet nën kujdesin e prindit apo të kujdestarit ligjor, me përfundimin e kujdesit prindëror apo të atij ligjor,
- c) në rastin e kujdestarisë së pjesshme për një fëmijë ende të palindur (në barkun e nënës), me lindjen e fëmijës
- d) në rastin e kujdestarisë së pjesshme lidhur me çështje të caktuara, me përfundimin e këtyre çështjeve,
- e) në rastin e kujdestarisë së pjesshme për një person të humbur apo të zhdukur, me hyrjen në fuqi të vendimit lidhur me deklarinim e personit si të vdekur ose me përcaktimin e kohës së vdekjes.